

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Driton Muharremi, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Have Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.M., nga Gjilani, për shkak të veprës penale marrja e rryshfetit nga nenit 428 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.94/17 të datës 21.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 04.dhjetor. 2017, mori këtë :

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e **pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.94/17, i datës 21.09.2017 **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.94/17 të datës 21.09.2017, i akuzuari L.M. në mungesë të provave e në bazë të nenit 364 par.1 nenpar.1.3, nenit 454 par.1 dhe nenit 463 par.3 të KPPK-së është liruar nga akuza për shkak të veprës penale marrja e rryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së.

Gjithashtu është vendosur që shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë qështje penale të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa i dëmtuari M.O. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan ta anuloj dhe qështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, apo të njejtin ta ndryshoj dhe të akuzuarin L.M. ta shpall fajtorë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe të njejtit t'i shqiptoj një sanksion penal meritor.

Përgjegje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan kanë ushtruar mbrojtësit e të akuzuarit L.M.-av.Shemsedin Pira dhe av.Isa Mustafa nga Gjilani, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan ta refuzoj si të pabazuar dhe aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, me shkresën e vet PPA.I.nr.485/17, të datës 02.11.2017 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpallë fajtorë për veprën penale që i vihet në barrë, apo të njejtin ta anuloj dhe qeshtjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje. Ndërsa përgjegjet në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan të parashtuara nga mbrojtësit e të akuzuarit të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, si dhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe gjeti se;

-Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan nuk është e bazuar.

Me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan pretendohet se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse i njejtë është në kundërshtim me brendinë e tij dhe faktet vendimtare, ngase gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar të gjitha provat e propozuara nga prokurori por vetëm i ka përshkruar në aktgjykim. Pra arsyetimi është i pamjaftueshëm e gjithashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor trupi gjykues ka shkelur dispozitat e procedurës penale duke lejuar mbrojtësin e të akuzuarit që të dëmtuarin-dëshmitarin M.O. ta ballafaqoj me deklaratën e tij të dhënë në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor, e i cili shqyrtim gjyqësor është i përfshirë në aktgjykimin lirues të nxjerrë nga e njejtja gjykatë.

Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se pretendimet e mësipërme ankimore lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale si ato që cekën në ankesë edhe ato të cilat gjykata e shkallës së dytë i konstaton sipas detyrës zyrtare nuk janë të bazuara. Aktgjykimin i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe konkret, nuk përmban kundërshtime qoftë me vetveten ose me arsyetimin. Në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në harmoni me nenin 370 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për qfarë arsyesh i ka marur si të provuara ose të paprovuara. Ajo ka bërë analizën e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në bazë të tyre ka nxjerrur konkludimet e veta, të cilat si të drejta dhe të ligjshme në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase në mënyrë të qartë janë provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor me fakte dhe prova konkrete edhe atë me prova materiale dhe personale se të i akuzuari L.M. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, gjegjësisht në veprimet e tij ekzistojnë elementet e veprës penale marrja e rryshfetit nga neni 428 par.1 të KPPK-së. Gjithashtu gjykata nuk i ka matur në mënyrë të njejtë peshën e provave fajësuese dhe shfajësuese.

Sipas Prokurorisë Themelore në Gjilan nga një vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shkelur edhe ligjin penal në

favor të akuzuarit, ngase provat të cilat e përcjellin aktin akuzues vërtetojnë se i akuzuari ka kryer me dashje veprën penale për të cilën akuzohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë nuk vëhet ne dyshim, ngase e njejtë është vërtetuar nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor. Deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit M.O. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor është kontradiktore, ngase i njejtë fillimisht në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori kishtë deklaruar se i akuzuari L. asnjëherë direkt nuk i kishtë kërkuar të holla atij, pastaj ka thënë se disa persona i kishin treguar se L.i nuk kryen ndonjë punë pa i dhënë para, ndërsa në fund kishtë deklaruar se L.i i'a kishtë kërkuar shumë prej 2700(dymijë e shtatëqind) Euro, për ta operuar nënën e të dëmtuarit në një spital privat.

Dëshmitari Sh.H.-P. hetues në deklaratën e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se M.O. në mëngjesin e datës 28.10.2013 kishtë shkuar në stacionin policor në Gjilan, me ç'rast i kishtë njoftuar policët se një mjek në Spitalin Regjional në Gjilan, respektivisht Dr. L.M. i'a kishtë kërkuar shumë prej 1500(njëmijë e pesëqind) Euro, për të operuar nënën e të njejtë. Më tutje ai ka deklaruar se pas përfundimit të planit operativ për simulimin e veprës penale të dhënies së rryshfetit janë shkuar në Spitalin Regjional në Gjilan, ku i dëmtuari M. është takuar me L.i dhe më pas kanë shkuar në zyrën e këtij të fundit dhe pasi që kanë dalur nga zyrja njësitit policor i hetuesisë në dollapin e zyrës së L. kanë gjetur banknotën në vlerë prej 500(pesëqind) Euro, e cila kishtë numrin serik të banknotës së M., të cilën policët e kishin skenuar me qëllim të realizimit të planit operativ për simulimin e veprës penale të dhënies së rryshfetit. Kjo deklaratë është në shpërputhje me deklaratën e të dëmtuarit M.O., pasi që dëshmitari Sh.H. ka përmendur shumë prej 1700(njëmijë e shtatëqind) Euro, për të cilin M.O. kishtë deklaruar në polici se L. po i'a kërkon atij për t'ia operuar nënën, ndërsa M.O. në asnjë rast nuk e ka përmendur këtë shumë të të hollave. Kurse, deklaratat e dëshmitarëve S.M. dhe A.L. dhe F.O. nuk kanë qenë të rëndësishme për vërtetimin e gjendjes faktike reale.

Sa i përket simulimit të veprës penale të dhënies së rryshfetit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur nuk ka marrë për bazë provat e siguruara nga veprimet e kryera me qëllim të simulimit të kësaj vepre penale për arsye se një gjë e tillë është kryer pa urdhër të gjykatës, pra në mënyrë të kudërligjshme.

Pra, sipas Gjykatës së Apelit të Kosovës pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk janë të bazuara dhe se gjendjen e vërtetuar faktike nga ana e gjykates së shkallës së parë e aprovon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, ngase në shqyrtimin gjyqësor para gjykatës së shkallës së parë nuk është vërtetuar me asnjë provë se L.M. t'i ketë kërkuar M.O.t të hollaryshfet për të kryer operacionin e nënës së këtij të fundit.

Pra, nga kjo del se te një gjendje e tillë e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar ligjin penal kur të akuzuarin L.M. e ka liruar nga akuza në mungesë të provave lidhur me veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.517/17, më 04.12.2017

Procesmbajtës
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Driton Muharremi

Have Haliti
